



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



PROCESVERBAL 1/2025

I Mbajtur në takimin e I-rë të rregulltë të KPF-së me datën **28.01.2025**, në ora **10⁰⁰** në Zyrën e takimeve të Kryetari i Komunës, nën kryesimin e Kryesuesit të KPF-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. Xhavit Zariqi, Kryesues;
2. Arian Imeri, Anëtar
3. Lumnije Morina, Anëtare;
4. Mimoza Pajaziti, Anëtare;
5. Lulzim Abazi, Anëtar;
6. Brahim Osmani, Anëtar;
7. Shqipe Jashari, Anëtare;
8. Hatixhe Bungu Qerimi, Anëtare;
9. Flamur Istrefi, Anëtar.

Drejtorët e drejtorive;

1. Arbër Bytyqi – Drejtor i Urbanizmit dhe Mjedisit;
2. Afrim Llabjani – Drejtor i Arsimit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Përshëndetje të pranishëm, anëtarë të KPF-së, shoqëria civile, Drejtor të drejtorive, pra po fillojmë me mbledhjen e I-rë të rregullt të KPF-së për këtë vit, besoi që materialin e keni marr me kohë dhe ju dëshiroi mirëseardhje në mbledhjen e KPF-së dhe propozojë këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së;

4. Propozim Vendim për orar të mbledhjeve të seancave të punës së kuvendit të Komunës së Ferizajt për vitin kalendarik 2025;
5. Propozim – Vendim për ndarjen e subvencioneve në lëmin e bujqësisë për Vitin 2025;
6. Propozim – Vendim për rishqyrtimin e vendimit me Nr.01.Nr.91 të datës 27.09.2024;
7. Propozim – Vendim për Shpallje Interes i Përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale; 63-5, 63-6 Z.K.Gërlaç, pronë private, me qëllim të këmbimit me ngastrën kadastrale 195-0 Z.K. Varosh, pronë e Komunës së Ferizajt;
8. Propozim - Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të banorëve të Fshatit Muhaxher;
9. Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të banorëve të Zaskokut;
10. Propozim - Vendim për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të Komunës së Ferizajt dhe CARITAS KOSOVA;
11. Propozim – Vendim për anulimin e Vendimit me nr. 01. Nr. 4978 datës 16.11.2007 dhe dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të “Banesës së Solidaritetit”;
12. Propozim – Vendim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrave kadastrale 719-0 dhe ngastrave kadastrale 715-2, 715-3, 704-0, 708-0 dhe 714-0 Z.K. Çernillë;
13. Propozim – Vendim për këmbimin e ngastrave kadastrale; 692-4, 694-2, 693-3 Z.K. Prelez i Jerlive, prona private, me pjesën e ngastrës kadastrale 1178-0 Z.K. Prelez i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt dhe
14. Të ndryshme.

Pika shitesë:

1. Propozim Vendim për këmimin e ngastrave kadastrale 1140-2 Z.K. Ferizaj, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 3280-0 Z.K. Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt;
2. Propozim Vendim për plotësimin e listës rezervë me emërtimet e rrugëve dhe shesheve publike në Komunën e Ferizajt;
3. Propozim Vendim për miratimin e Rregulorës për transparencë dhe Planin e veprimit për transparencë Komunalet për Vitin 2025-2028

Pika 1

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Fillojmë me pikën e I-rë të rendit të ditës, Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së, të gjithë jemi prezent.

Pika 2

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Miratimi i rendit të ditës, a ka dikush të diskutoi rreth rendit të ditës,

Arbër Bytyqi – Faliminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë anëtarët e KPF-së, të nderuar drejtor , i kam dy propozime, njana ka të bëjë me Propozim - Vendimin për këmbimin e ngastrave kadastrale 1140-2 Z.K. Ferizaj, pronë private, me pjesën e ngastres kadastrale 3280-0 Z.K. Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt, i ka përfunduar vlerësimin në ministri, vetëm duhet të miratohet dhe me kalu në kuvend mbasi i ka klaluar të gjitha procedurat, gjithashtu e kam një propozim tjetër, e murët materialin më herët për këtë pikë, Propozim - Vendim për plotësimin e listës rezervë me emërtimet e rrugëve dhe shesheve publike në Komunën e Ferizajt, pra janë këto propozime të reja që propozoi që përmes të KPF-së të kalohet në seancën e radhës të kuvendit dhe materialin tjetër e sjellim në seancë.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Drejtor ky propozim për emërtimin e rrugëve, a mujna me shty, apo nuk mundemi?

Arbër Bytyqi – Kyesues e kena shty.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Drejtor, janë disa ndryshime, p.sh. këtu e kam një ankesë, besoi që shumë të arsyeshme Rr. “Hyzer Haxhiu” kush ja ka ndru emrin e rrugës, kush ka guxu me ja ndru.

Arbër Bytyqi – Kyesues e kisha ba një skjarim, kjo lista e emrave rezervë është listë e emrave e cila përdoret te rrugë të reja, ndryshimi i emrave ekzistues është kry me vendim të kuvendit të komunës, që është miratuar në Vitin 2019 si listë përfundimtare edhe me hi me procedur ligjore, nuk është që kena me ja ndryshu emrin, d.m.th. krejtë ankesat që na vijnë te na si Drejtori e Urbanizmit në bazë ligjore me i ndru emrat, nuk është që mujna na me i ndru, që është miratu në Vitit 2019, kjo është vetëm për ata që i kanë maru dy tre shpija dhe gjatësia është më pak se 100 metra dhe prej kësaj liste kena me marr një emër dhe me ja vendos naj sheshi të rijë, këto që janë vendos kryesues, tash veç janë ba abdete edhe në gjeoportali edhe përmes sistemit ARIS d.m.th. në bazë ligjore nuk mundet me ju ba ndërimi i këtyre emrave, e di që kena pas ankesa të vazhdueshme dhe jena ballafaqu me ankesa të zyrtarëve, mirëpo baza ligjore për ndërim nuk është dhe gjithashtu kjo pikë nuk ka të bëjë.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Nuk po them kurgja, por po bajë pyetje, kush ka guxu me ndërru?, e ka pas emrin në bazë ligjore dhe ju ka ndryshu emri dhe ju ka hjek tabela, në radhë të parë kush nuk e ka ditë kush është kanë Hyzer Haxhiu, duhet me ditë se kjo nuk bahet fjalë për një njeri të thjesht, por të zakonshëm, për një person shumë kontributdhënës, i angazhuar për çështje kombëtare, për liri edhe nuk ka kuptim me ju hjek emri.

Arbër Bytyqi – Është ba 2019.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Po them qaj komision që e ka marr vendim me e ndryshu këtë emër, ai duhet me dhanë llogari se nuk ka mundësi kështu me ndodhë.

Arbër Bytyqi – Kryesues, për kesi raste zakonishtë është zhvendos në një vend më të rëndësishëm, shka kam pa deri tash, nuk jam kanë pjesë e këtij procesi, se jam kanë shumë i angazhum dhe shka kam mundur me pa është zhvendos me naj zonë më të rëndësishme.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Drejtor nuk po du me të akuzu ty për këtë çështje, rruga e ka pas emrin ku e ka pas shtëpinë i ndjeri, edhe nuk ka asnjë arsye me ju ndryshu.

Arbër Bytyqi – Tash është problemi qe 8 vjet nuk mujna me ndru, 8 apo ma shumë nuk e di sa ashtë me ligj.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Është ndryshu e tash nuk ekziston ai emër.

Arbër Bytyqi – Kryesues unë mundem me verifiku këtë si rast, këtë emër, ban vaki është i zhvendost krejt tjetërkund edhe 10 vjet kur skadon qyky vendimi i kuvendit që është marr 2019, kur bahet Viti 2029 banë vakia nuk mundesh me e kthy në vend ku u kanë, nëse është vendos dikun në adresë tjetër, unë e verifikoi dhe të njoftoi.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Duhet me e verifiku edhe me rikthy emrin qysh e ka pas, se fund të fundit zyrtarisht është vendos emri, me merit ju ka vendos emiri, e ka meritu shumë ma shumë, po logjikisht çfar ndryshime ka ndodh nuk është e pranueshme, kjo çështje është që të diskutohet gjërë e gjatë dhe të verifikohet kush ka guxu me ba këto ndryshime.

Arbër Bytyqi – Është kanë një komision që është formu në Vitin 2013-2014 nëse nuk gabo, 2019 qaj komision është, e ka pru listën e rrugëve, rrugicave dhe Shesheve, është miratu në kuvend dhe veç kanë fillu dhe i kanë vendos, por kjo nuk ka të bajë me ato.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Kjo është një çështje që vërtet ka ndodhë pa asnjë logjikë, pa asnjë të drejt, pa asnjë të drejtë morale, e as njerëzore, unë edhe atëherë kam thanë dhe tash po e përsërisë, ai komision duhet me u përgjegj, duhet me shku në burgë, edhe nuk duhet me i ba këto sene qysh i ka ba, plus asaj janë pagu me meditje ai komision në kuptimin e mbledhjeve që kanë mbajt edhe asnjë punë nuk e kanë ba siç duhet, por kjo çështje është për diskutim dhe thash të diskutohet në kuvend dhe duhet të mirret dikush në përgjegjësi, se kështu nuk banë, Hyzer Haxhiu ka qenë figure, personalitet kontributdhënës edhe me luft me emrin e tij nuk banë, kur dihet se ky komision kanë propozu emra të fëmijëve sa kanë lindë, emrin e rrugës ja kanë lanë, nuk jam tu të akuzu ty drejtor, po kjo çështje është e ndishme, nuk ka kuptim kështu, këtë çështje duhet me ngrit në kuvend dhe me bisedu me e rikthy dhe me e rishqyrtu listën në tërësi, nuk ka guxu me ndru emrin.

Arbër Bytyqi – Kryesues qe 10 vjet nuk e di sakt, kanë me u kthy në kuvend.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Unë po ju kuptoi, por si komision i kanë ndru emrat pa asnjë përgjegjësi.

Arbër Bytyqi – Kush e ka ndru nuk e di, por si vendim është miratu në kuvend.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Unë jam kanë në komision në fillim kur janë ba emërtimet e rrugëve, unë personalisht, Agim Aliu dhe shumë të tjerë, këtë emër na e kena vendosë, qysh ka ndodh me ndërru unë nuk e di.

Lumnije Morina – A e ka tabelën me emër.

Mimoza Pajaziti - Ka shumë rrugë në sistem që figuron me tjetër emër.

Arbër Bytyqi – Unë nuk besoi që e kanë hjek komplet, kanë mujt me e zhvendos dikund, po po bazona për shembull që kam pa prej ankesave të qytetarëve, po të njoftoi kryesues detajisht, ku është, çysh është me këtë emër, po të njoftoi detaisht qysh ashtë vendimi që është marr 2019 në kuvend për këtë listë, kjo listë është rezervë dhe që duhet me pas na.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Urdhëro drejtor!

Afrim Llabjani – Faliminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, meqenëse mungon Drejtorja e administrates me autorizoi me e propozu këtë Propozim Vendim për Miratimin e Rregulores për transparencë dhe Planin e Veprimit për Transparencë Komunale për Vitin 2025-2028, të gjitha procedurat janë kry, sot i mora informacionin, po vetëm se duhet të kaloj në kuvend dhe të nxjerret vendim dhe të miratohet.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit drejtor, kush është që të kaloj në kuvend rendi i ditës me tri pikat e shtesë të propozuara për kuvend?, faleminderit, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e III-të të rendit të ditës.

Pika 3

Kryesuesii KPF-së Xhavit Zariqi – Vazhdojmë me Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të KPF-së; a ka dikush ndonjë vërejtje rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar, si duket jo, a jeni që të kaloj procesverbali i mbledhjes së kaluar?, faleminderit, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e IV-të të rendit të ditës.

Pika 4

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim Vendim për orar të mbledhjeve të seancave të punës së Kuvendit të Komunës së Ferizajt për Vitin kalendarik 2025, a ka najkush të diskutoi rreth orarit të mbledhjeve të KK-së për Vitin 2025, ju e dini se kjo është formalisht dhe se ndonjëherë mund të ndryshoi, a jeni që të kaloj kjo pikë e rendit të ditës në kuvend?, faleminderit, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e V-të të rendit të ditës.

Pika 5

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Propozim – Vendim për ndarjen e subvencioneve në lëmin e bujqësisë për Vitin 2025, drejtori mungon por po e procesojmë këtë pikë për kuvend, kush është që të kaloj pika e V-të?, faliminderit, 6 vota për, 1 kundër, 0 abstenim, pra kalon për kuvend, vazhdojmë me pikën e VI-të të rendit të ditës.

Pika 6

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për rishqyrtimin e vendimit me Nr.01.Nr.91 të datës 27.09.2024, urdhëro drejtor!

Arbër Bytyqi – U kanë pengë në bankë, e tash propozohet me u hjek bara, me u vazhdu procedura e me kalu kjo pikë në kuvend.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faleminderit, a dëshiron të diskutojë dikush tjetër për këtë pikë?, jo, a jeni që të kaloj në kuvend?, kush është që të kaloj pika e VI-të?, faliminderit, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e VII-të të rendit të ditës.

Pika 7

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për Shpallje Interes i Përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale; 63-5, 63-6 Z.K.Gërlicë, pronë private, me qëllim të këmbimit me ngastrën kadastrale 195-0 Z.K. Varosh, pronë e Komunës së Ferizajt, drejtor a mundesh me na sqaru për këtë pikë të rendit të ditës.

Arbër Bytyqi – Kryesues, kjo pikë është me kërkesë të palës, me qëllim këmbimi, mbasi nuk jam i informuar më detaisht për sa i përket kësaj pike dhe se drejtori për një angazhim familjar nuk është këtu, propozoi që të kaloj për kuvend dhe në kuvend pastaj të ipen informata të detajuara, është kërkesa e palës që ju ka drejtuar infrastrukturës, po besoi që është për naj rrugë, që ju ka marr parcela.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit drejtor, a dëshiron dikush t'a merr fjalën për këtë pikë?, a jeni që të kaloj në kuvend, e pastaj e shofim?, kush është që të kaloj pika e VII-të?, faliminderit, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e VIII-të të rendit të ditës.

Pika 8

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të banorëve të Fshatit Muhaxher, urdhëro drejtor!

Arbër Bytyqi – Kryesues, e këqyra është fjala për Fshatin Dremjak Lagjja “Muhaxheri” është kërkesa e Këshillit të fshatit ka të bëjë për ndërtimin e objektit për të pame.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Është një gabim teknik, a ka tjerë të interesum për diskutim, a jeni që të kaloi në kuvend pika e VIII-të e rendit të ditës?, faliminderit, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon edhe vazhdojmë me pikën e IX-të të rendit të ditës.

Pika 9

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të banorëve të Zaskok-ut, urdhëro drejtor!

Arbër Bytyqi – Kryesues, ky propozim është e njejtë me propozimin e mëparshëm për të pame.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – A ka tjerë të interesum për diskutim, a jeni që të kaloi në kuvend pika e IX-të e rendit të ditës?, faleminderit, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon edhe vazhdojmë me pikën e X-të të rendit të ditës.

Pika 10

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të Komunës së Ferizajt dhe CARITAS KOSOVA, drejtor a po na sqaron për këtë pikë?

Afrim Llabjani – Faliminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë, materialin edhe pse nuk e keni marr me kohë, marrveshjen e kemi bashkangjitur, është kërkesa e jona që ky Propozim – Vendim që të kaloi përmes kuvendit, në mënyrë që të krijoji një qëndrueshmëri dhe një staf të Kopshtit “Engjujt” dhe kështu që e dimë se kemi një bashkëpunim të mirë me CARITAS KOSOVËN, ka shku mirë bashkëpunimi deri më tani edhe për të pasur një qëndrueshmëri më të gjatë, kemi propozuar që kjo marrëveshje të jetë tri vjeçare dhe të miratohet në kuvendin e komunës, që pastaj na ta vazhdojmë punën të kësaj çerdhe, e cila është e domosdoshme, nuk po

flasim për rëndësinë e saj sepse ju e dini të gjithë, prandaj kërkojmë që ky Propozim – Vendim të kalojë për miratim në kuvendin e komunës, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faleminderit drejtor, a dëshiron dikush të diskutojë?, drejtor kjo marrëveshje a është vetëm për punëtorët për Kopshtin “Engujt”?

Afrim Llabjani – Është për Kopshtin “Engujt” e precizime me marrëveshje dhe është për punësimin me Qendër të Punësimit Socialo - Edukative në Dubravë, ato e kemi pas në vazhdimsi të lidhur me këtë marrëveshje për shkak të fëmijëve të komunitetit që e ndjekin një edukim parafillor aty në atë qendër.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Faleminderit drejtor, a dëshiron dikush të diskutojë?

Brahim Osmani - Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë, të nderuar drejtor, s’ pari ne kemi marr disa vendime në kuvendin komunal, të cilat janë përfunduar, e ju si PDK i keni kry, deshta me ditë se prindërit a kanë pagu, kanë pagu edhe me rritje të çmimit, a është kjo marrëveshje tjetër?, a jeni tu ditë ku jeni tu jetu, apo ju ka hup rruga në oborr, që 4 seanca jeni tu na për propozimin çdo herë të ri, njëherë për shpenzim e pastaj në kuvend duhet me ja rrit çmimin, pastaj vini prap me marrëveshje me CARITAS KOSOVA, e me CARITAS-in gjithmonë duhet me pas marrëveshje, duhet me pas me Komunë e CARITAS, unë e di që është i vërtet, po ju nuk jeni tu e respektu, ju keni për vendime shumë të këqija, veç me ju shku mendja me ju dhanë për shfrytëzim, e keni për ma keq që është e mundur, tash me ato pare që i kanë dhënë prindërit, shka do të bani me ato pare?, e para pagesa për janar, qysh do t’i bani punëtorëve pagesat, edhe e dyta për punëtorë që keni ba hajgare aty, shka keni ba me ta, a keni kërku të paktën falje, se është shumë e rëndësishme mi thanë dikujna hajt shkoni në shtëpi, e dikujna që e keni pas ma të afërt aty, hajde vazhdoni, kjo ka mbet që 5 muaj apo 6 që e këna na marrëveshjen, tash me çerdhe tjera nuk dina shka këna me ba me ta, qysh kanë me funksionalizu të tjerat, se kjo ndoshta është marrëveshje, do të realizohet, po shka me ba me tjerat?, ku mbetet interesi pas kësaj marrëveshje prap?, dhe sa ka me qenë çmimi, se ky çmim me marrëveshje nuk është çmim me CARITAS, qysh keni me ba, edhe çmimi edhe kurgja nuk ka, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Faleminderit urdhëro Flamur!

Flamur Istrefi – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, këtë pikë e kam par që e keni për gabim në këtë seancë dhe drejtori thotë se është kontratë tri vjeçare 2027 Janar, pra është një marrëveshje 2 vjeçare, 2026 dhe mbaron me 31 Janar 2027, jo 3 vjeçare, por përtej kësaj po mendojë që kjo ka ndryshime taman në kohë të fushatave, i keni majt peng punëtorët deri tash në kohë të zgjedhjeve dhe në aspektin ligjor nuk e di, a keni drejt në kuvend me ba marrëveshje bashkëpunimi me letësim një burimore me dhanë veç me menagju, nëse duhet një kryetar i komunës me favorizu përtej asaj që duhet, unë besoi që asnjë raport që nuk e ka ba, pra ka qenë

njëfarë kontrabandimi i punëtorëve që është ba, por raport sakt nuk ka që e ka ba, unë mendoj me ja dhanë CARITAS-it marrëveshjen, plus që thuhet se 30% e mbulon CARITAS-i, që e kanë ba me mbulu, që asnjë cent nuk ju ka dhanë CARITAS-it, janë 140 mijë euro me atë 30% që kanë me dhënë prindërit s'bashku me CARITAS-in, që mundet me u mbulu kjo shumë, kështu po dojnë me kamoflu diçka që nuk duhet, mos u ngutni drejtor, i keni krejt mundësit me dhanë në shfrytëzim, tash po dojna pak me ja dhanë CARITAS-it, por të paktën jo kuvendit, unë për veti si kuvendar as nuk e votoi një propozim të tillë, për të mirën e saj është dashtë të bëhet një zgjidhje për këta punëtorë që janë aty, faliminderit.

Afrim Llabjani – Faliminderit Brahim dhe Flamur, ju e dini se ka shku një procedur dhe është ky një procedurë sa i përket dhënies në shfrytëzim këtyre institucioneve, gjegjësisht objekteve që i kemi, mirëpo çerdhja, objekti i çerdhës me CARITAS-in që nuk funksionon Kopshti “Engjujt” nuk ka qenë në listën e dhënies së objektit në shfrytëzim, ne i kemi pas disa marrëveshje të cilat, janë shpallur nëpërmes të shpalljes publike, por që nuk kanë funksionalizu më herët, në mënyrën më të mirë të mundëshme, prandaj për të bërë një gjë të tillë u afrua një marrëveshje duke u bazuar në një legjislacion të cilën e kemi shkruar në preambulën të cilën e kemi përmendur edhe ligjet, arsyet, pastaj tjetra Brahë, që janë marr ato pare për pagesa, kanë me u kthi ato pare, pagesa nuk do të rritet, do të jetë 50€, qysh ka qenë deri me tani, shumë tjetër do ta mbuloi komuna, qysh ka mbulu deri më tani, tani vetëm përqinja është 70 % e ka komuna me financu, ndoshta 30% e ka CARITAS-i, punëtorët e CARITAS-it Brahim, askush nuk i ka thanë me shku në shtëpi, as nuk i ka veçu kush me nejt, e kush mos me nejt, por secila me menagjimin e CARITAS-it, përndryshe punëtorët kanë qenë jashtëzakonisht të mirëkuptueshëm, kështu që na kanë mirëkutu edhe neve, kështu që na kanë mbet problemet edhe problemet tjera të cilat na kanë ndodhë gjatë këtij ruktimi, por kanë punu, pagesat janë kry, nëse nuk gaboi ditën e djeshme ose ditën e sotme më s'largëti, d.m.th. janë kry të gjitha pagesat çka i kena pas borgj atyre punëtorëve, kështu që po besoi që është një fillim i ri dhe një fillim që i mbart dhe që i përcjellë për ata që kanë 220 fëmijë të sistemuar në atë çerdhe, ndërsa sa i përket këtu Flamur të 31.01. besoi që është gabim teknik, se duhet të jetë 31.12.2027, këroi falje për këtë punë, te marrëveshja kohëzgjatja është 3 vjeçare duke filluar 01.02.2025-31.12.2027, por marrëveshja është qashtu, pra marrëveshja është e parapame 3 vjeçare, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Dikush tjetër, urdhëro Lumnije!

Lumnije Morina – Deri sa lëshon kuvendi i komunës një vendim për lidhje të marrëveshjes së Komunës me CARITAS-in, këtu te neni 5 te raportimi, kujt i raportohet, a i raportohet Kuvendit të komunës apo dikujt tjetër?

Afrim Llabjani – Këtu në bazë të vlerave të menagjimit i raportohet Drejtorisë së Arsimit, për punën, për angazhimin për monitorimin dhe për krejt ajo çka ndodhë, këtu gjithmon bëhet një monitorim i cili ndodhë kohë pas kohshme në atë çerdhe, ne bashkarisht me CARITAS-in shumë shpesh i vizitojmë, për shkak të kushteve se na i kena mirëmbajtjen, e kena komplet këtë pjesën e kanalizimit, ujësjellësit, shpenzimet komunale edhe rrymën që e kemi, të gjitha këto që i keni këtu, por na që i përgjigjemi si drejtori.

Lumnije Morina – A ka randësi na që po marrim një vendim në këtë rast e të raportohet edhe në kuvend së paku një herë në vjet.

Afrim Llabjani – Po s'paku për shkak të bazës së asaj pune që është bërë për një vjet me CARITAS-in, e nëse mirret një vendim i tillë edhe me ndryshime mujna me ba ndryshimin, megjithse kjo është propozim marrëveshje, por e rëndësishme është me vazhdu funksionalizimi, me ba funksionalizimin e çerdheve, faliminderit.

Brahim Osmani – Faliminderit kryesues, e para që mu ka përgjigj drejtori kur e ke ba marrëveshjen a e ke pas fjalën për shfrytëzimin e të gjitha çerdheve në Ferizaj, çka është fati që është në Greme, dhe normal me marrëveshjen që e keni pas në kuvend, ju e keni pa që këta punëtorë që janë kanë me punu edhe në çerdhe në Greme, me u funksionalizu edhe në çerdhe të tjera edhe në Greme.

Afrim Llabjani – Pra unë nuk po premtoi, po jemi duke punuar aq shumë sa me funksionalizu që është kognja e gatshme, por përkundër të mungesës së mjeteve që kena për me funksionalizu, por nga ajo që jemi duke bërë, për punën, besoi që shpejtë do të funksionalizoi, ne kemi edhe një marrëveshje tjetër me CARITAS-in që është përmes shpalljes publike, në kuadër të asaj na kena me planifiku me funksionalizu edhe çerdhen e Gremës, kurse sa i përket kësaj që janë dhënë në shfrytëzim, janë edhe 3-4 objekte të tjera që janë në përfundim, bile në Fshatin Babush veç pritët të përfundoi shkolla që është adaptu dhe ka mundësi që në javën e ardhëshme me u ba përrurimi i kësaj, pastaj duhet me dhanë për shfrytëzim qysh e kena ba edhe vendimin në kuvendin komunal, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit, urdhëro Flamur!

Flamur Istrefi – Diskutimet të gjitha që janë lidhur me zgjedhjet ZKA-së në të kaluemën, ku thotë: që komunat me CARITAS Kosova ka me pas të nënshruar marrëveshje me bashkëpunim me bashkëmenagjim dhe financim pa u zhvilluar asnjë marrëveshje konkurrese dhe menagjuese, d.m.th. drejtor është ZKA-ja nga zyra e auditimit që ka treguar që këto marrëveshje janë bazuar me ligj, e në rend të parë mos ta bajmë llugë këtë formë të marrëveshjes, e jo që gjithshka që është e lidhur me kuvendin.

Afrim Llabjani – Flamur, nuk mendoi që është hudhje topi, po një zgjidhje të problemit dhe funksionimit të çerdhes, e cila është jashtë funksionalizimit, sepse ne e dimë që kemi vetëm një çerdhe publike, e cila na mbetet në funksion, sa për pagesat, për shërbimin e fëmijëve, për marrjen e shërbimeve duke u bazuar në preambullë që e kena në propozim – vendim, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit a jeni që kjo pikë e rendit të ditës të kaloi në kuvend, faleminderit, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon edhe fillojmë me pikën e XI- të rendit të ditës.

Pika 11

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Propozim – Vendim për anulimin e Vendimit me nr. 01. Nr. 4978 datës 16.11.2007 dhe dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të “Banesës së Solidaritetit”, urdhëro!

Arbër Bytyqi – Kjo ka të bajë me ish banesën që e ka dorëzu ish luftari i UÇK-së Gazmend Bytyqi me kërkesë të Organizatës të Shoqatave të Dalura nga Lufta e UÇK-së, kërkohet që t'i ipet një personi tjetër, shënimet të gjitha i keni në kërkesë dorzuar nga Shoqata të Dalura nga Lufta, po besoi që është kërkesë e duhur më se i nevojshëm dhe shumë meritore, tash ju e vlerësoni, në fakt Shoqata e Invalidëve të Luftës ka ba kërkesën.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Ky propozim duhet të ketë kohë, se ka procedura të kaloi nëpër komision për dhënie të banesave, se kuvendi i shkel rregullat tona, pa asnjë interes, nuk jam kundër që të kaloi, por u kanë dashtë të shkoi në komision, komisioni me vlerësu dhe me na sjell në kuvend.

Arbër Bytyqi – Afat shkurt

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Afat shkurt! Shka u ba deri tash që nuk ka pas banesë.

Arbër Bytyqi – Për shkak procedurale është afat shkurt.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Absolutisht, nuk është e drejtë, megjithatë kuvendi e ka një komision për dhënien e banesave me qira edhe ai komision duhet me vlerësu me propozu në kuvend, e na me marr vendim, nuk ka logjik kështu drejt për drejt në kuvend, d.m.th e ka dorëzuar, e po ja japim këtij.

Arbër Bytyqi – Po pajtona kryesues, nëse ishte kjo kërkesë afatgjatë, por afat shkurtë është.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Afat shurtër e kanë pasë edhe ata para njëzet vjete, por i kanë hala, e realisht komuna nuk ka të drejtë në menagjim të pronave të veta, ka persona që i kanë marrë banesat mbas lufte, e nuk kanë ndëjtë në ato, por sot i kanë lëshu me qira, më vjenë keq që unë po flas në krye veti, po ka procedur të rregullt.

Lumnije Morina – Kur janë dhanë banesat e solidaritetit, shoqatat janë marr vesh dhe janë dakordu dhe kanë marr pëlqim, e nëse duhet të shkoj përmes komisionit atëherë është në rregullë.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Nëse shkon nëpërmes të komisionit atëherë është në rregullë, por nëse jeni ju shumica me votu dakord ta votojmë, unë nuk kam kurgja kundra.

Lumnije Morina – Mos po na bahet vonë, në këtë kohë të ftoftë, Gazmendi e ka lëshu atë banesë.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Ajo është pronë e komunës, për atë komuna ju ka dhanë shoqatave banesat me qira, por nuk donë me thanë se shoqata mund me vendos kuja donë me ja dhanë, nuk ka logjikë, nuk është pronë e shoqatës ajo.

Lumnije Morina - Kryesues me vend e ki.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Shoqata nuk mundet me vendos këtë çështje, shoqata e ka propozu, por e ka pas të drejtën me e propozu në komision, komisioni me e vlerësu dhe të na sjelli në kuvend, qysh doni vendosni, unë për veti jam kundër shkeljeve të rregullave, nuk ka logjikë kështu.

Mimoza Pajaziti – Është rast i rand kryesues, ka mbet keq, mos ta lam Veteranën e lufës jashtë, unë për vete nuk muj.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Po e shkel procedurën, nuk e ki marr fjalën.

Mimoza Pajaziti – I kena shkej procedurat ma të rënda, ku po nalemi këtu, ju vet i keni shkelë, se krejt mediat këtu.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Me dashtë me ba mirë këtu ashtë diçka tjetër, e me i thy procedurat është diçka tjetër, nuk ka asnjë kuptim shoqata me propozu për me ja dhanë banesën pa i ndjekë procedurat, nuk është objekt i shoqatës, është pronë e komunës,

Lumnije Morina – Shoqata mundet me propozu, po na po e marrim vendimin, na mundemi me votu pro dhe kundër.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Unë mundem me votu, por kur të vjen nëpërmes komisionit, se nuk ka asnjë kuptim.

Mimoza Pajaziti – Kryesues me vend e ki.

Lumnije Morina – A është funksionale komisioni në këtë komunë.

Arbër Bytyqi – Në aspektin ligjor për dhënie afatshkurtër nuk ka nevojë, nuk është e domozdoshme, por u kanë mirë me kalu nëpër komision, por nuk është e domozdoshme me kalu nëpër komision në aspektin ligjor deri 15 vjet.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Afat shkurtër është 6 muaj deri një vjet, e jo deri në 15 vjet.

Arbër Bytyqi - Garant kjo ka me ardhë edhe njëherë me ju caktu afati, se nuk e di sakt këtë pjesë.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Unë e qes këtë pikë me votu, unë personalisht nuk mundem me votu, pa u kry procedurat, kush është për?, faleminderit, 3 vota për, 4 kundër, 0 abstenim, pra nuk kalon dhe le ta djekin procedurën e kalojmë, fillojmë me pikën e XII- të rendit të ditës.

Pika 12

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Propozim – Vendim paraparak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrave kadastrale 719-0 dhe ngastrave kadastrale 715-2, 715-3, 704-0, 708-0 dhe 714-0 Z.K. Cërnillë, drejtor a mundesh me na tregu për këtë pikë?

Arbër Bytyqi – Kryesues u mundova me këqyrë në dosje, po e ka një telashe me bashkëshorten, këtu janë disa prona të listës së dhanuna për shfrytëzim, tash për lokacionin e sakt nuk e di, po në propozim është që me dal në kuvend.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - A jeni që ta shtyejmë për seancën tjetër?, kush është për me shty për seancën tjetër?, faleminderit, 7 vota për, 4 kundër, 0 abstenim, fillojmë me pikën e XIII- të rendit të ditës.

Pika 13

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Propozim – Vendim për këmbimin e ngastrave kadastrale; 692-4, 694-2, 693-3 Z.K. Prelez i Jerlive, prona private, me pjesën e ngastrës kadastrale 1178-0 Z.K. Prelez i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt, urdhëro drejtor!

Arbër Bytyqi – Është bërë vlerësimi përfundimtar, ministria e ka vlerësua barabart pronat nga 35€ për m², kërkoi që të bëhet vendimi përfundimtar, mbasi është bërë vlerësimi në ministri.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Kush është që të kaloj?, faleminderit, 7 vota për, 4 kundër, 0 abstenim, fillojmë me pikën e XIV- të rendit të ditës.

Pika 14

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Propozim Vendim për këmbimin e ngastrave kadastrale 1140-2 Z.K. Ferizaj, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 3280-0 Z.K. Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt, Drejtor a po diskuton për këtë pikë?

Arber Bytyqi – D.m.th. edhe këtu është për vlerësim përfundimtar, Propozim Vendimi për këmbimin e ngastrave kadastrale 1140-2 Z.K. Ferizaj, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 3280-0 Z.K. Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt, këtu simbas vlerësimit janë marr 605 m², ndërsa ju kanë dhanë 572 m².

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - A dëshiron dikush të diskutoi?, a jeni që të kaloj kjo pikë, faleminderit, 5 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, fillojmë me pikën e XV- të rendit të ditës.

Pika 15

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Propozim Vendim për plotësimin e listës rezervë me emërtimet e rrugëve dhe shesheve publike në Komunën e Ferizajt, drejtor a po diskuton për këtë pikë?

Arbër Bytyqi – Kryesues kjo është një Propozim - Vendim për plotësimin e listës rezervë me emërtimet e rrugëve dhe shesheve publike në Komunën e Ferizajt.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - A dëshiron dikush të diskutoi?, a jeni që të kaloj kjo pikë, faleminderit, 5 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, fillojmë me pikën e XVI- të rendit të ditës.

Pika 16

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Propozim Vendim për miratimin e Rregulorës për transparencë dhe Planin e veprimit për transparencë Komunale për Vitin 2025-2028, drejtor a po diskuton për këtë pikë?

Afrim Llabjani – Po kryesues, është Propozim Vendimi për Miratimin e Rregulorës për transparencë dhe Planin e veprimit për transparencë Komunale për Vitin 2025-2028, pas pashmëryshimit të udhëzimit administrativ kushtuar për të harmonizuar, d.m.th. komuna i ka kry të gjitha procedurat.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - A dëshiron dikush të diskutoi?, a jeni që të kaloj kjo pikë, faleminderit, 5 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, fillojmë me pikën e XVII- të rendit të ditës.

Pika 17

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Të ndryshme, A dëshiron dikush të diskutoi?

Flamur Istrefi – Çështja e kryetarëve të fshatrave në lagjen e qytetit, jo me shty prej seancës në seancën tjetër, jo mu kanë kundra.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Unë e kam ditë në seancën e kalueme këtë punë, nuk mundemi me marr vendim kur nuk ka përfund, qysh me marr vendim.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Masi nuk ka diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, me kaq po e mbyllim mbledhjen e KPF-së, faleminderit për pjesëmarrje.

Procesmbajtësja



Zyliha Tafarshiku

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi

